



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	29/13
Nr. i fq. / Br. st	-9-
Data: / Datum	28.02.2013
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

## PROCESVERBAL

### Nga mbledhja e I-rë për vitin 2013, e Kuvendit Komunal në Vushtrri, mbajtur më 31.01.2013

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën 10:10. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Arta Ismajli, Avdullah Halimi, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Ergin Sunguri, Esat Beka, Ferit Idrizi, Gani Imeri, Gjylsime Feka, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Nysret Gërxhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Krustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Syzana Sylja, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Xhemajl Pllana, Vlora Qirezi dhe Zeqir Hasani.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Habib Mustafa - kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

**Habib Mustafa, kryesues i kuvendit-** propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe propozimi për anëtarësim në komitetet këshillëdhënëse.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** paraqiti vërejtje për kryetarin e komunës, sepse ka kaluar një muaj për dy shkresa i ka drejtuar dhe për asnjërin nuk ka marrë përgjigje, me ç'rast ka kërkuar informatë lidhur me një objekt që është ndërtuar përgjatë rrugës kryesore se a është ndërtuar në pronë private apo publike, kurse kërkesa tjetër ka pas të bëjë me trajnimet të cilat i ka ndjekur stafi i komunës (qofshin shërbyes civil apo politik), ku është kërkuar të përmendet lloji i trajnimit, emrat e zyrtarëve që kanë marrë pjesë në trajnime, profesioni, pozita që mban në administratë të komunës, kush e ka ofruar trajnimin, kur është mbajtur trajnimi?

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** duke iu referuar vërejtjes së B.Jasharit lidhur me kërkesën e dytë për informatë, tha se në mbledhjen e kaluar të kuvendit ka dhënë sqarim verbal, por tha se nëse ka parashtruar pyetje me shkrim edhe përgjigjet do t'i merr me shkrim.

**Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, kuvendi me vota unanime miratoi këtë:**

#### **REND DITE**

- 1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e KK-së, mbajtur më 27.12.2012.**
- 2. Shqyrtimi i Draft-rregullores për procedurat e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale (shqyrtimi i dytë).**
- 3. Shqyrtimi i Raportit për punën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2012.**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete.**
- 5. Shqyrtimi i Informatës për punën e Grupit të Grave Deputete.**
- 6. Shqyrtimi i Peticionit të qytetarëve të fshatrave: Sfarçak, Nadakoc dhe Mavriq.**
- 7. Të ndryshme:**
  - a. Propozimi për anëtarësim në komitetet këshillëdhënëse të KK-së.**
  - b. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.**

**1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e KK-së, mbajtur më 27.12.2012.**

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** tha se te faqja 3, pika nr.3, iu është cunuar diskutimi i tij, pasi që nuk janë përfshirë dy apo tri raste konkrete, prandaj kërkoi që të përfshihen në procesverbal. Gjithashtu në faqen 6 iu ka referuar tabelës, me ç'rast kërkoi që të përmendet në procesverbal.

**Qazim Azemi, anëtar i kuvendit-** tha se është mirë që në procesverbal kur flitet për mungesat e anëtarëve të kuvendit, të dihet se a janë mungesa të arsyeshme apo të paarsyeshme. Kurse në faqet 9 dhe 10, kërkoi që të figurojë edhe replika e tij, kur është debatuar për peticionet. Gjithashtu në faqen 10, tha se lidhur me peticionin e parë nuk është vendosur unanimitet, pasi që ka pas mospajtime nga anëtarët e kuvendit.

***Aprovohet unanimitet procesverbali në fjalë, me vërejtjet dhe sugjerimet e R.Ramajt dhe Q.Azemit.***

**2. Shqyrtimi i Draft-rregullores për procedurat e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale (shqyrtimi i dytë).**

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** tha se draft-rregullorja në fjalë ka një peshë dhe rëndësi të madhe, sepse rregullon çështjen e dhënies së pronave, që është një çështje e ndjeshme dhe me rëndësi për komunën tonë. Pastaj duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, paraqiti këto vërejtje: te paragrafi 2.2, kërkoi që të hulumtohet dhe të vërtetohet se a është afatshkurtër apo afatmesëm; te paragrafi 4.3, propozoi që në komision të jetë edhe një anëtar më shumë i kuvendit të komunës, pasi që kuvendi ka përgjegjësi në këtë çështje; nenit 6 propozoi t'i shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje: "çdo pjesëmarrës në ankand duhet t'i përmbushë të gjitha obligimet ndaj komunës"; te paragrafi 12.5, kërkoi që të caktohet një afat i njoftimit; te paragrafi 12.7, tha se nga përvojat e dëgjua në nivel të Kosovës në procesin e privatizimit është lënë hapësirë që të manipulohet dhe keqpërdoret interesi publik, sidomos në rastet e tërheqjes së ofertuesit të parë dhe dhënia e pronës ofertuesit të dytë, prandaj propozoi që nëse ofertuesi i parë tërhiqet, procedura duhet të përsëritet.

**Ismet Gashi, anëtar i kuvendit-** së pari u pajtua me vërejtjet dhe sugjerimet e paraqitura nga M.Shabani, pastaj paraqiti këto vërejtje: kërkoi sqarime lidhur me paragrafin 4.6, dhe propozoi që paragrafi në fjalë të hiqet i tëri; te paragrafi 13.7 propozoi këtë riformulim: “përbashkë, shfrytëzuesve të tokës ndërtimore të cilët shfrytëzojnë këtë pronë konform dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi, iu lejohet shfrytëzimi deri në përfundimin e kontratës”.

**Ferit Idrizi, anëtar i kuvendit-** lidhur me draft-rregulloren në fjalë, paraqiti këto propozime: te paragrafi 4.1, propozoi që komisioni të ketë mandat 6 muaj ose 1 vit; te paragrafi 4.2, propozoi që në vend të fjala “persona” të zëvendësohet me fjalën “anëtarë”.

**Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, paraqiti këto vërejtje dhe propozime: te neni 2, propozoi që të shtohet edhe joshja e investitorëve të jashtëm; te paragrafi 2.2, tha se shfrytëzimi afatgjatë është mbi 15 vite, por nëse e lejon ligji, propozoi që ky afat të rritet deri në 20 vite, pasi që do të jetë interesimi më i madh i investitorëve për një periudhë më të gjatë të shfrytëzimit; paragrafit 2.3 propozoi t’i shtohen edhe: “ofrimi i likuiditetit të ofertuesit, pasqyra bankare dhe tatimore”. Gjithashtu propozoi që në këtë rregullore të ndahet prona bujqësore nga ajo komerciale, në mënyrë që të mos kenë të drejtë që në ankand të marrin pjesë si personat juridik, ashtu edhe fizik; te paragrafi 6.2, tha se ka dallim nëse ankandi anulohet, duke shtuar se nëse nuk mbahet, është e drejtë t’i kthehet depozita, por nëse ankandi mbahet dhe fituesi përzgjidhet, atëherë nuk ka rregullativë ligjore që mund t’ia kthejë depozitën.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të PDK-së e përkrahu draft-rregulloren në fjalë, dhe shtoi se përcaktimi i afatit dhe përbërja e komisionit janë të parapara në këtë mënyrë përmes ligjit.

**Enver Morina, zyrtar ligjor-** duke iu referuar vërejtjeve të paraqitura nga anëtarët e kuvendit, paraqiti sqarime shtesë lidhur me draft-rregulloren në fjalë.

**Ismet Gashi, anëtar i kuvendit-** lidhur me paragrafin 13.6, tha se në këtë rregullore nuk janë parapara dispozitat ligjore sipas të cilave mund të largohen objektet që janë vendosur në pronë komunale, kur komunës i nevojitet ajo parcelë, do të bëhet një plan i vendosjes së kiosqeve në një vend të caktuar dhe shpallet ankandi, por sipas dispozitës 13.7 (që hartuesi tha se duhet të jetë), të gjithë shfrytëzuesit mund të thirren në të, që nuk kemi të drejtë t’ua heqim kiosqet, pasi që ceket deri në zbatimin e planeve rregulluese.

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** e mbështeti diskutimin e Z.Hasanit dhe shtoi se kur në një ankand shpallet fituesi, të tjerët që nuk kanë fituar nuk iu kthehen mjetet. Pastaj tha se nuk ka plan afatshkurtër 15 vite, por ka vetëm 1 vit.

**Enver Morina, zyrtar ligjor-** sqaroi se ligji e konsideron afatshkurtër periudhën prej 1-15 vite, kurse afatgjatë është mbi 15 vite deri në 99 vite.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Aprovohet Rregullorja për procedurat e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, duke inkorporuar të gjitha sugjerimet, propozimet dhe vërejtjet të cilat nuk janë në kundërshtim me ligjin.***

### **3. Shqyrtimi i Raportit për punën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2012.**

**Qazim Azemi, anëtar i kuvendit-** tha se raporti në fjalë nuk është i plotë, prandaj duhet të plotësohet dhe shtoi se në këtë raport duhet të përshkruhet sesi paraqitet puna e kuvendit në mjetet elektronike, si është parë puna e kuvendit në sytë e të tjerëve, qoftë nga MAPL-ja, qoftë nga OJQ-të. Po ashtu kërkoi që të paraqitet në raport arsyetimi pse nuk është mbajtur mbledhja e KK-së në fund të muajit mars, për

ta precizuar se a ka munguar pozita apo opozita. Mandej tha se në raport mungon puna e Grupit të Grave Asambleiste, duke shtuar se grupi në fjalë ka bërë aktivitete të mira. Pastaj tha se në raport mungon numri i vendimeve të KK-së që janë anuluar nga MAPL-ja. Gjithashtu në raport mungon numri i pyetjeve të paraqitura nga anëtarët e kuvendit, si dhe numri sesa përgjigje janë dhënë për ato pyetje, kurse për KPF-në nuk ka fare raportim, pasi që është mirë të përshkruhet se çka ka punuar KPF-ja dhe cilat kanë qenë vështirësitë gjatë punës së tij. Në fund propozoi që raporti në fjalë të plotësohet.

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** tha se raporti në fjalë duhet të mbështetet në Planin e Punës së Kuvendit dhe të bëhet një krahasim i realizueshmërisë së planit të punës, sepse ky raport nuk ka sjell një krahasim të rezultatit të punës, të objektivave që ka pasur kuvendi. Pastaj tha se në raport ka pjesë të panevojshme ku ka përshkrime të rregullores së punës, pasi që raporti duhet të sjellë çështjet përmbajtësore, dhe të krahasohen zërat përkatës të planit, pra raportet duhet të sjellin një matshmëri të punës, si dhe sa ka ndikuar puna e kuvendit brenda vitit në përmirësimin e jetës së qytetarëve, apo në rregullativën ligjore të komunës. Gjithashtu tha se në raport nuk është përmendur ndonjë iniciativë e qëlluar, e cila ka pasur rezultate konkrete, ose për hir të transparencës sa iniciativa kanë qenë që janë përfillur dhe kanë pasur rezultate, apo sa janë përfillur propozimet e opozitës. Në fund sugjeroi se në tabela nuk vendosen pikat, por vetëm krijohet një ndarje.

**Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit-** kërkoi që të merren parasysht për t'u përfshirë në raport edhe vërejtjet e paraqitura nga anëtarët e kuvendit, pasi që raporti në fjalë është pasqyrë e punës së kuvendit për një vit. Pastaj kërkoi që në raport të sqarohet se për cilat arsye është ndërprerë mbledhja e KK-së, duke precizuar se cili subjekt politik e ka braktisur mbledhjen. Gjithashtu tha se është mirë që të bëhet një komparacion në mes të asaj që është planifikuar dhe asaj që është arritur, si dhe çka nuk është arritur.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar faqes nr. 5 të raportit në fjalë, lidhur me fjalinë "gjithashtu është me rëndësi të theksohet se kontributi i shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në këtë drejtim për disa rregullore ishte shumë i vogël, prandaj mbetet të hulumtohen shkaqet në të ardhmen", shtoi se edhe në diskutimet tjera publike pjesëmarrja e qytetarëve është e vogël, prandaj nuk është ky një fenomen që vetëm në vitin e kaluar është paraqitur, dhe kjo është bërë një dukuri që po na përcjell, dhe për këtë arsye duhet të diskutohet ku qëndron problemi, cilat janë shkaqet e një mospjesëmarrjeje të tillë të qytetarëve. Pastaj tha se kjo vjen si rezultat i humbjes së besimit të qytetarëve ndaj të gjithë përfaqësuesve të vet. Në fund kërkoi që kryetari i komunës ta marrë seriozisht dhe të bëjë përpjekje që në të ardhmen të jetë më i madh interesimi për debatim publik.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar vërejtjeve të anëtarëve të kuvendit lidhur me raportin në fjalë, tha se mbledhja e KK-së në të cilën nuk ka pas kuorum, sqaroi se në bazë të LVL-së është e drejtë e çdo anëtari të kuvendit të marrë apo të mos marrë pjesë në mbledhje. Pastaj tha se OJQ-të e kanë dhënë vlerësimin e tyre lidhur me punën e kuvendit. Po ashtu USAID-i e ka dhënë vlerësimin se Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë është kuvendi më transparent për dy vite radhazi. Në fund lidhur me pjesëmarrjen e publikut në diskutime publike dhe në mbledhje të kuvendit, tha se që të gjitha janë të hapura edhe për publikun.

**Veli Karaça, anëtar i kuvendit-** tha se edhe raportit në fjalë mund t'i jepen disa vërejtje, por ky kuvend është shpallur dy vite me radhë kuvendi më transparent dhe më funksional në krahasim me të gjitha kuvendet komunale në Republikën e Kosovës, prandaj asnjë raport nuk është i përkryer, dhe shtoi se kuvendi i komunës ka funksionuar shumë mirë, ka pas bashkëpunim në mes të grupeve parlamentare, ka pas transparencë dhe mundësi që të gjithë ta japin kontributin, me ç'rast është çmuar kontributi i të gjithëve, prandaj kërkoi që sot të aprovohet raporti në fjalë.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** tha se nga një raport mund të nxirret ndonjë përfundim, rekomandim dhe qëndrim për të përmirësuar atë që mund të përmirësohet në periudhën e ardhshme, prandaj kjo mungon në këtë raport, sepse del se plani nuk ka qenë në rregull, pasi që janë planifikuar 38 pika të rendit të ditës, kurse janë debatuar 112 pika të rendit të ditës. Pastaj tha se statistikën nuk po përputhen në dy tabela. Gjithashtu tha se ajo që është shumë me rëndësi dhe e nevojshme, por që mungon (përveç nivelit lokal) edhe në nivelin qendror, është pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje, prandaj pyeti se çka duhet bërë që të ketë një prezencë më të madhe në përgatitjen e vendimmarrjes nga qytetarët. Tutje tha se në raport thuhet se të gjithë anëtarët e kuvendit kanë marrë pjesë në vizitën në Shqipëri, por duhet thënë që disa nga anëtarët e kuvendit, pasi që nuk kanë marrë pjesë të gjithë. Mandej tha se për aprovimin e vendimeve kapitale nuk ka pas konsensus, por ka pas mbivotim, kurse në fund tha se kuvendi i komunës është duke e shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës, pasi që mungon fotografia e presidentes së shtetit.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** lidhur me vërejtjen se është humbur besimi i qytetarëve ndaj institucioneve lokale, tha se kjo mbetet me u pa në zgjedhjet lokale. Pastaj lidhur me pjesëmarrjen e dobët në diskutime publike, tha se në fillim kur janë organizuar tubimet publike, salla e Qendrës së Kulturës ka qenë e mbushur plot, kurse me kalimin e kohës ka rënë numri i pjesëmarrësve, por kjo mund të ndodh edhe për shkak të realizimit të shumë projekteve që janë në favor të qytetarëve. Kurse tha se fotografia e presidentes së shtetit është e vendosur në zyrën e kryetarit të komunës, por edhe në sallën e kuvendit të komunës duhet të vendoset një fotografi e presidentes së shtetit.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Aprovohet Raporti për punën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2012, duke inkorporuar shumicën e propozimeve të anëtarëve të kuvendit.***

#### **4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete.**

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** tha se në raport janë paraqitur 33 pika të shqyrtuara, të cilat janë kërkesa të ndryshme të qytetarëve dhe nuk duhet të jenë pjesë e raportit. Pastaj tha se nuk po e di pse është bërë një kërkesë vetëm për fshatin Smrekonicë, dhe pse nuk janë përfshirë edhe fshatrat tjera. Në fund tha se komiteti në fjalë duhet të jetë funksional në përgjithësi, në realizimin e detyrave dhe përgjegjësiive ligjore.

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** tha se raporti në fjalë është marrë me përkrahjen e kërkesave dhe nuk është marrë me esencën për çka është i autorizuar, dhe shtoi se ky raport është dashtë të orientohet në punën dhe interesat e komuniteteve (në veçanti për komunitetet pakicë), për integrimin e tyre në shoqëri.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** tha se në raport është dashtë të paraqiten aktivitetet që janë realizuar nga komiteti, rezultatet që janë arritur brenda periudhës së caktuar, të paraqiten vështirësitë që i ka pas, si dhe pengesat që i ka has. Pastaj tha se askund në raport nuk paraqitet nëse ka pas ndonjë projekt që ndërlidhet me gjendjen e komuniteteve në aspektin social, arsimimin dhe gjendjen në aspektin e shëndetësisë.

**Naile Osmani, anëtare e kuvendit-** sqaroi se kërkesën e ka bërë në cilësinë e anëtares së komitetit në fjalë, dhe ia ka adresuar KFOR-it për renovimin e shkollës në fshatin Smrekonicë.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** replikoi se ajo kërkesë është bërë në rrugë të keqe, pasi që është manipuluar me pozitën e anëtares së komitetit, meqë kërkesa bëhet përmes kryetarit të komunës, apo qeverisë lokale.

**Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit-** tha se Komiteti për Komunitete ka realizuar dy herë vizita nëpër shtëpitë e komuniteteve të ndryshme, por në mungesë të buxhetit, iu ka ndihmuar vetëm përmes Kryqit të Kuq.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** tha se hartuesi i raportit në fjalë nuk e ka bërë një raport adekuat të punës së Komitetit për Komunitete dhe ka evidentuar të gjitha kërkesat që janë bërë, duke mos evidentuar saktë për çka është fjala. Pastaj tha se institucionet e komunës kanë dialog me të gjitha komunitetet, po ashtu Komuna e Vushtrrisë është ndër komunat që më shumti ka realizuar projekte nëpër vendbanimet ku jetojnë komunitetet. Gjithashtu tha se ka njaft projekte të realizuara, por pa rezultate, duke përmendur se në fshatin Maxhunaj janë ndërtuar 35 shtëpi, por banorët nuk janë kthyer që të jetojnë në ato shtëpi edhe pse kanë nënshkruar marrëveshjet për kthim, dhe njësoj është vepruar edhe në disa fshatra të tjera. Në fund tha se ndërtimi i urës në fshatin Prelluzhë ka relaksuar raportet në mes të komunitetit serb dhe atij shqiptar.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Aprovohet Raporti vjetor për punën e Komitetit për Komunitete.***

##### **5. Shqyrtimi i Informatës për punën e Grupit të Grave Deputete.**

**Veli Karaça, anëtar i kuvendit-** tha se Grupi asambleist i LDK-së i përshëndet dhe e përkrah punën e Grupit të Grave Asambleiste, i inkurajon që të vazhdojnë me një intensitet të shtuar, për t'i identifikuar fushat ku mund të japin kontribut, dhe njëkohësisht i sugjeron që të mos merren me aktivitete administrative, por t'i identifikojnë nevojat, të hartojnë projekte, si dhe të merren më pak me aktivitete të vogla, e më shumë me projekte që e zgjedhin një çështje. Në fund tha se në mungesë të buxhetit për ndonjë projekt më të madh, propozoi që të realizohen projekte me faza.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-** tha se Grupi asambleist i PDK-së e përshëndet punën që ka bërë Grupi i Grave Asambleiste, dhe i inkurajoi që të vazhdojnë të punojnë edhe në të ardhmen.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** tha se nga informata në fjalë, shihet se Grupi i Grave Asambleiste ka ndërmarrë shumë iniciativa për realizimin e disa projekteve. Pastaj tha se ndër projektet me rëndësi është edhe nisma për realizimin e kontrollit sistematik të nxënësve të shkollave të Komunës së Vushtrrisë. Në fund tha se Grupi asambleist i AAK-së e përkrah informatën në fjalë.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** tha se e përkrah punën e Grupit të Grave Asambleiste dhe vlerësoi pozitivisht bashkëpunimin në mes të Grupit të Grave Asambleiste dhe deputetes në Kuvendin e Kosovës nga Komuna e Vushtrrisë, por edhe me Agjensionin për Barazi Gjinore të Zyrës së Kryeministrit, pasi që ky është një shembull për kuvendin e komunës, por edhe për kreun e komunës sesi duhet të bashkëpunohet dhe koordinohen aktivitetet, me qëllim që rezultatet të jenë më të mira.

**Gjylsime Feka, anëtare e kuvendit-** tha se Grupi i Grave Asambleiste ka marrë pjesë në shumë tryeza, por nuk i ka cekur në informatën në fjalë. Në fund tha se Grupi i Grave Asambleiste do të jetë një zë pozitiv i punës dhe i angazhimit të femrave për komunën tonë.

**Islam Krasniqi, anëtar i kuvendit-** e përkrahu punën e Grupit të Grave Asambleiste, por sugjeroi që në vitet e ardhshme grupi në fjalë të orientohet tek gratë të cilat kanë dhunë në familje, si dhe ato që kanë probleme me kancerin.

## **6. Shqyrtimi i Peticionit të qytetarëve të fshatrave: Sfaraçak, Nadakoc dhe Mavriq.**

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-** në emër të Grupit asambleist të PDK-së kërkoi një pauzë prej 5 minutash për konsultim me shefat e grupeve asambleiste lidhur me peticionin në fjalë.

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** lidhur me peticionin në fjalë, tha se shefat e grupeve asambleiste njëzëri janë pajtuar që të shikohet ligjshmëria e vendimit që është marrë, dhe para së gjithash të respektohet vullneti i komunitetit në tri fshatrat (e përmendura në peticion), si dhe të shtyhet zbatimi i këtij vendimi, dhe të mos merret një vendim i ngutshëm për të mos rënë në kundërshtim me ligjin dhe me vullnetin e qytetarëve.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Kuvendi i Komunës konsideron të arsyeshëm shqetësimet e komuniteteve të fshatrave Nadakoc, Sfaraçak dhe Mavriq.***

***Kuvendi i Komunës i obligon drejtoritë kompetente që të hulumtojnë lokacion tjetër për kryerje të shërbimeve me automerimangë, si dhe t'i propozoj kuvendit të komunës miratimin e vendimit për mbledhjen e radhës për caktimin e lokacionit të ri.***

## **7. Të ndryshme:**

### **a. Propozimi për anëtarësim në komitetet këshillëdhënëse të KK-së.**

**Qazim Azemi, anëtar i kuvendit-** në emër të Grupit asambleist të AAK-së kërkoi që propozimi në fjalë të shtyhet për mbledhjen tjetër të KK-së, pasi që pikët e paraqitura për kandidatët, janë bërë pa praninë e panelit përzgjedhës, dhe shtoi se është mëkat që është eliminuar Alban Feka, kurse ka fituar kandidati që e ka kryer shkollimin privat.

**Vlora Qirezi, anëtare e kuvendit-** tha se Grupi asambleist i LDK-së e përkrah punën e panelit përzgjedhës për anëtarësimin e anëtarëve në Komitetet Këshillëdhënëse.

**Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit-** tha se në këtë konkurrencë, ka pasur djem dhe vajza shumë të mirë, me përgatitje shkollore shumë të lartë, me ide të fuqishme, dhe çdo anëtar i panelit përzgjedhës e ka pas vështirë të përzgjedh, pasi që ka pas konkurrencë të fortë. Gjithashtu tha se nuk do të bëhet zgjedhje ekonomike për konkurrentët. Në fund tha se secili anëtar i panelit përzgjedhës ka votuar veçmas, dhe pas mbledhjes së pikëve, ka dalë rezultati, por propozoi që lista me kandidatët që nuk janë pranuar në komitetet konsultative të ruhet dhe në të ardhmen të merren parasysh këta kandidatë, në rastet kur ka ndonjë konkurs.

**Esat Beka, anëtar i kuvendit-** kërkoi sqarime për Komitetin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, lidhur me kandidatin Rafet Zeka, i cili ka 555 pikë, kurse Makfirete Brahimi i ka 540 pikë.

**Habib Mustafa, kryesues i kuvendit-** sqaroi se në Komitetin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore ka fituar një kandidate nga komuniteti turk.

**Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit-** tha se ka pas kandidatë shumë të kualifikuar dhe kërkoi që të aprovohet lista propozuese për anëtarët në komitetet këshillëdhënëse.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për”, 5 “kundër”, të tjerët “abstenim” vendosi me sa vijon:**

**Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komitetit Këshillëdhënës për Arsim, Kulturë, Fe, Rini dhe Sport në këtë përbërje:**

1. **Fatmir Hoxha,**
2. **Liridon Hajdini,**
3. **Bedri Xhema,**
4. **Agron Pllana,**
5. **Liridona Kosumi,**
6. **Lavdiqe Dërguti,**
7. **Tatjana Slavic.**

**Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komitetit Këshillëdhënës për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, në këtë përbërje:**

1. **Shkelzen Keliqi,**
2. **Alban Hyseni,**
3. **Qenan Maxhuni,**
4. **Fidan Feka,**
5. **Jusuf Haradinaj,**
6. **Edona Karaça,**
7. **Lulzime Zeneli.**

**Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komitetit Këshillëdhënës për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në këtë përbërje:**

1. **Hamit Xhaferi,**
2. **Isak Hyseni,**
3. **Shyqyri Syla,**
4. **Mentor Hasani,**
5. **Alban Mikushnica,**
6. **Arjeta Krasniqi,**
7. **Arbaneta Zekolli.**

**Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komitetit Këshillëdhënës për Ekonomi dhe Shërbime Publike në këtë përbërje:**

1. **Sabit Nura,**
2. **Valon Feka,**
3. **Nysret Vojvoda,**
4. **Gëzim Nasufi,**
5. **Afrim Zekolli,**
6. **Mehreme Gërguri,**
7. **Floriana Musiqi.**

**Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komitetit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në këtë përbërje:**

1. **Hyrijet Ukshini,**
2. **Besnik Murati,**
3. **Valmire Hyseni,**
4. **Ardian Beqiri,**
5. **Shkëndije Pllana,**
6. **Bashkim Asllani,**
7. **Makfirete Brahim.**



**b. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.**

**Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit-** tha se në mbledhjen e kaluar ka bërë kërkesë që Drejtoria për Shërbime Publike të paraqesë një informatë për mirëmbajtjen e rrugëve në Komunën e Vushtrrisë në rastin e përkeqësimit të motit dhe gjendjes që është krijuar, për të cilën e ka marrë përgjigjen. Ai kërkoi që të gjitha informatat që parashtrihen në kuvend t'iu dërgohen të gjithë anëtarëve të kuvendit në mënyrë që të hapet debati rreth problemit dhe çështjes që është paraqitur.

**Qazim Azemi, anëtar i kuvendit-** kërkoi që të kompensohet mëditja për të gjithë anëtarët e kuvendit për mbledhjen e jashtëzakonshme të KK-së.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** duke iu referuar vërejtjes së Q.Azemit, tha se nëse e lejon ligji, do të kompensohet edhe mëditja për mbledhjen në fjalë të përmendur nga Q.Azemi.

**Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit-** kërkoi që të zgjidhet edhe zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** tha se komunitetet pa i pasur 10 % të popullatës, nuk kanë të drejtë të kenë zëvendëskryesues të kuvendit.

**Qazim Azemi, anëtar i kuvendit-** lidhur me bursat për studentët, pyeti se a do të ketë konkurs, pasi që ka shumë kërkesa për bursa të studentëve.

**Mbledhja përfundoi në orën 12:10.**

**Procesmbajtësi**



**Alban Tahiraj**

**Kryesuesi i Kuvendit**



**Habib Mustafa**